REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PER MUAJIN JANAR 2026

Nr. Rendor[1]	Data e kërkesës[2]	Objekti i kërkesës [3]	Data e përgjigjes [4]	Përgjigje[5]	Mënyra e përfundimit të kërkesës[6]	Tarifa[7]
1	23.12.2025	Sa është vlera e shpenzuar për bileta avioni dhe akomodim për udhëtimet jashtë shtetit të realizuara për periudhën 01.01.2025-23.12.2025?Cilët kanë qene destinacionet dhe cilët kanë qenë punonjësit që kanë udhëtuar?	25.02.2026	Kthyer përgjigje sipas kërkesës....	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

1 Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
2 Data e regjistrimit të kërkesës
3 Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
4 Data e kthimit të përgjigjes
5 Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
6 Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
7 Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionrmacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoritëti publik.

2	29.12.2025	Sa është nrumri i personave me aftesi te kufizuar qe kane perfituar nga programet e nxitjes se punesimit 2019-2025. Sa është numri i personave me aftesi te kufizuar te punesuar ….Masa e fondit social te dedikuar per personat me aftesi te kufizuar ne vitet 2019-2025. Sa është numri I PAK qe ka ndjekur kurset e formimit profesional 2019-2025.	08.01.2026	Kthyer përgjigje sipas kërkesës....	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

3	30.12.2025	Kërkesë për informacion nese jam fitues i kredise apo jo dhe cfar hapash duhet te ndjek, theksoj se kam shkuar edhe tek Bankat Credins, BKT dhe Raifasien per t`u informuar dhe me kane thene se ska ardhur gje.	07.01.2026	Ju njoftojme se banka qe eshte perzgjedhur nga Komisioni i Vleresimit te ofertave te bankave ne zbatim te vendimit Nr. 468, datë 26.7.2023 "*Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës*" eshte **Raiffaisen Bank.** Ju mund te paraqiten ne nje nga filialet e bankes Raiffeisen javen qe vjen, gjithashtu do te njoftoheni edhe nga banka personalisht.	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

4	05.01.2026	Kërkesë për dokumentacion lidhur me zbatimin e detyrave të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030, për institucionin tuaj, në 6 muajt e parë pas hyrjes në fuqi.	30.1.2025	Në kuadër të kapitullit 30, synohet përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar me Rregulloren (BE) 2019/452 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte (FDI Screening). Në muajin Korrik 2025 është miratuar Ligji nr. 56, datë 03.07.2025, "Për një ndryshim në Ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993, 'Për Investimet e Huaja', i ndryshuar". Ky amendim i ligjit siguron harmonizimin me rregulloren e BE-së. Në periudhën maj – gusht 2025 eshte hartuar projekt VKM "Për miratimin e rregullores mbi procedurat për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte që lidhen me ose ndikojnë infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me të dhëna kritike, qasjen në informacion të ndjeshëm apo për lirinë e medias", dhe draft rregullorja mbi procedurat e shqyrtimit të FDI-së. Ky dokument eshte	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

				dërguar për mendim pranë Komisionit Evropian si dhe është është dërguar për konsultim publik dhe bashkërendim me institucionet e linjës. Risi: Ky projektvendim synon miratimin e rregullores për procedurat e vlerësimit dhe shqyrtimit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Projektakti krijon për herë të parë një mekanizëm shtetëror për shqyrtimin e IHD-ve në Shqipëri për arsye të sigurisë kombëtare apo rendit publik		

5	07.01.2026	Kërkesë lidhur me statusin e projektit të restaurimit të ish-godinës së Radio Tiranës.	08 janar 2026	Në vijim të kërkesës suaj për informacion lidhur me statusin e projektit të restaurimit të ish-godinës së Radio Tiranës, ju informojmë se kjo çështje **nuk bën pjesë në fushën e përgjegjësisë institucionale të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)**. Për rrjedhojë, MEI nuk disponon informacion zyrtar mbi aspektet e paraqitura në kërkesën tuaj, përfshirë procedurat e ndjekura, afatet e zbatimit, ndryshimet në projekt, çështjet e pronësisë, financimit apo përgjegjësitë ligjore për vonesat.Për marrjen e informacionit të detajuar dhe zyrtar, ju sugjerojmë t'i drejtoheni institucionit përgjegjës për administrimin, miratimin dhe zbatimin e projekteve të trashëgimisë kulturore dhe restaurimit të objekteve historike.	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

6	05.01.2026	Kërkesë për vënie në dijeni se në cilën periudhë kohore parashikohet shpallja e listës së fituesve për Thirrjen për Grante, “Fondi për Përfaqësimin Kombëtar dhe Mobilitetin” 2025.	07 janar 2026,	Objekti i kërkesës nuk eshte ne fushen e pergjegjesise se MEI-t.	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka
7	12.01.2026	Kerkese per informacion mbi aplikimin on-line për te përfituar nga programet e strehimit social .	14 janar 2026	Aplikimi on-line për te përfituar nga programet e strehimit social kalon direkt në strukturën përgjegjëse për strehimin në bashkinë në të cilën ju jeni regjistruar, keni aplikuar dhe ku shqyrtohet dhe vlerësohet dokumentacioni i plotë i aplikimit.	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

8	16.01.2026	Kerkese per informacion mbi një kopje të listës së aplikantëve të pranuar në këtë projekt deri më tani.Cila është adresa e saktë e parkut teknologjik "Durana" Ju pretendoni se ky projekt në 20 vitet në vazhdim do të sjellë gati 3. 5 miliardë euro fitim, sipas deklaratave të dhëna. Si është llogaritur ky fitim, kur iu është dhënë përfituesve shumë lehtësira, gati deri në 0% tatim përfitimi mbi të ardhurat e përfituesve 4.Sipas deklaratave, pretendoni se aktualisht projekti është në fazë virtuale dhe se po ndërtohet në anën fizike. Si funksionon faza virtuale? Kërkojmë një kopje të procedurave të ndjekura për funksionimin e kësaj faze. 5.Në cilën datë supozohej të niste ndërtimi i infrastrukturës së këtij parku? Kërkojmë një kopje të vendimit të nisjes së ndërtimit, së bashku me detajet se sa	21 janar 2026	Në lidhje me pikën 1, në zbatim të VKM-së nr. 418, datë 07.07.2023, "Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e përdoruesve në parqet teknologjike dhe shkencore", çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, ka të drejtë të paraqesë pranë zhvilluesit të parkut kërkesë për miratimin si përdorues për ushtrimin e aktivitetit brenda parkut teknologjik dhe shkencor. Shqyrtimi i aplikimeve dhe vendimmarrja për miratimin ose refuzimin e subjekteve si përdorues i përket zhvilluesit të parkut, i cili vepron në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit nuk ushtron kompetenca vendimmarrëse në këtë proces, por njoftohet nga zhvilluesi vetëm në rastet e miratimit, në funksion të ushtrimit të rolit të saj, kordinues dhe monitorues, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për rrjedhojë, informacioni mbi listën e subjekteve që kanë aplikuar apo janë miratuar për ushtrimin e aktivitetit në "Durana Tech Park", administrohet nga Korporata e Investimeve Shqiptare, në cilësinë e zhvilluesit të parkut.Në lidhje	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

				me pikën 2, në zbatim të ligjit nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, vendimi për hapjen e parkut teknologjik dhe shkencor përmban edhe përcaktimin e vendndodhjes së tij. Në këtë kuadër, me VKM-në nr. 185, datë 27.03.2024, të ndryshuar, është miratuar hapja e Parkut Teknologjik dhe Shkencor “Durana Tech Park”, me sipërfaqe 14 (katërmbëdhjetë) hektarë, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Durrës, në pasurinë me nr. 336, të llojit “truall”, zona kadastrale 3852.Në lidhje me pikën 3,4,5,6,7, ju informojmë se në zbatim të nenit 23/1, të VKM-së nr. 337, datë 31.05.2023, të ndryshuar, me propozimin tëe ministrisë përgjegjëse për ekonominë, autorizohet institucioni përkatës publik, për ushtrimin e rolit të zhvilluesit të parkut, në vendimin për hapjen e tij, pas paraqitjes së kërkesës së argumentuar nga nga ana e subjektit të interesuar.Zhvilluesi, brenda afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë Planin e Detajuar të Zhvillimit, së bashku me draft-marrëveshjen përkatëse, të cilat		

				miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në këtë kuadër, me VKM-në nr. 73, datë 29.01.2025, janë miratuar Plani i Detajuar i Zhvillimit dhe draft-marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe zhvilluesit, Korporata e Investimeve Shqiptare, për angazhimet e ndërsjellta lidhur me ndërtimin, administrimin, funksionimin, operimin dhe monitorimin e Parkut Teknologjik dhe Shkencor "Durana Tech Park"		
9	23.01.2026	Kërkesë për informacion lidhur me programin e strehimit social te kredise se bute 3%.	26.2.2025	Ne zbatim te pikes 1 dhe 2 te Vendimit Nr. 384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore" citohet fakti se:Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në strukturën përgjegjëse për strehimin të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit të aplikantit. Si dhe "…. dhe familjet që janë të regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse..".Per sa cituar me siper ju munde te bleni shtepi	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

				vetem brenda territorit te Bashkise Durres, aty ku jeni qytetare dhe jeni shpallur fituese me Vendim te Keshillit Bashkiak te kesaj Bashkie.		

10	18.01.2026	Informacion lidhur me disa të dhëna për z. Gjergji Taho, në cilësinë e anëtarit pranë Komisionit të Licencave, si përfaqësues i MEI.	21.01.2026	Sqarojmë, se Ministria përgjegjëse për ekonominë ushtron kompetencat e saj në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe vetëm brenda fushës së përgjegjësive që i janë përcaktuar nga ligji. Komisioni i Licencave për Lojërat e Fatit funksionon pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF), institucion që është në varësi të Ministrisë së Financave, e cila mban përgjegjësinë institucionale për organizimin, funksionimin dhe administrimin e këtij komisioni.Përfaqësimi i institucioneve në këtë komision, si dhe procedurat që lidhen me emërimin, ushtrimin e funksionit, deklarimin dhe verifikimin e kushteve ligjore apo të konfliktit të interesit të anëtarëve të tij, rregullohen nga legjislacioni përkatës dhe trajtohen nga institucionet kompetente të përcaktuara nga ligji. Ministria përgjegjëse për ekonominë nuk administron dhe nuk disponon	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

				dokumentacionin që ju kërkoni lidhur me aplikime individuale, vlerësime, procesverbale, deklarime personale apo vendimmarrje të Komisionit të Licencave, për sa kohë këto procese nuk bëjnë pjesë në fushën e saj të përgjegjësisë administrative dhe institucionale.Ministria e Ekonomise dhe Inovacionit mbetet e angazhuar për respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe integritetit institucional, si dhe për bashkëpunimin ndërinstitucional sa herë që kjo kërkohet dhe lejohet nga kuadri ligjor në fuqi		

11	24.01.2026	Kerkese per informacion Verifikimin e menjëhershëm të veprimeve dhe mosveprimeve të Degës së Shoqërive Publike Berat;Vendosjen e përgjegjësisë institucionale për vonesat e krijuara;Dhënien e udhëzimeve të qarta dhe afateve konkrete për përfundimin e procedurës së privatizimit;Një përgjigje zyrtare me shkrim mbi statusin aktual të çështjes.	28.01.2026	Per sa i perket objektit "Depo e farnave 2 kat" ne Lushnje e ish Ndermarrjes se Farnave, ne varesi te Bashkise Lushnje, miratuar per privatizim me urdher privatizimi nr.1523/4 prot, date 10.11.2014, eshte bere ringritja e komisionit te vleresimi nr.5301/6 prot, date 19.12.2024, procesi i privatizimit ka nisur me njoftimin nr.21 prot, date 09.01.2026 vendosur ne objekt per efekt te ish-pronareve te truallit, nqs ka. Komisioni e vleresimit eshte ne fazen e hartimit te gen-planit dhe konfirmimit te tij ne prefekture dhe ndjekjen e te gjitha fazave te percaktuara sipas procedures. Ky proces, sipas parashikimeve ligjore, duhet te perfundoje ne fundin e muajit Mars 2026. Ne perfundim raporti se bashku me te gjithe dokumentacionin sillet prane Drejtorise se Privatizimit per trajtim te metejshem dhe marrjen e vendimeve perkatese te cilat i paraqiten ministrit per miratim.Shenojme ketu qe	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

				qofte Komisioni i vleresimit, po ashtu edhe Drejtoria e Privatizimit e ka rreptesisht te ndaluar komunikimin me palet e interesuara, qofshin keto edhe pronaret e truallit, te cilet gezojne te drejten e parablerjes. E gjithe procedura e ndjekur nga Komisioni i Vleresimt shqyrtohet nga Drejtoria e Privatizimit dhe me pas Komisioni i Shqyrtimit te Transparances ku vjen e perfunduar dosja nga ky Komision, atehere dhe arsyetohet dhe merren masa per shkelje te procedurave apo vonesave ne proces, per cilindo qe i ka shkatktuar ato. I vetmi komunikim qe duhet te beje komisioni i vleresimit gjate procesit, bazuar ne ligj dhe VKM-te perkatese eshte me institucionet si : institucionit administrues te prones, ne kete rast Bashkia Lushjnje, prefektura perkatese, ATP dhe ASHK dhe te gjitha keto me shkresa dhe te dokumentuara. Komunikime te tjera dhe dhenia e informacionit per		

				kedo tjeter eshte e ndaluar rreptesisht.Objekti shitet ne fund me ankand dhe aspak pales se interesuar, kjo bazuar ne VKM 926 dhe si e tille, informacionet dhe komunikimet me kedo ne kete faze te procesit demtojne rende parimin e besueshmerise dhe barazise se pjesemarrjesve ne ankand e cila zhvillohet nga Drejtoria e Shitjes.Objekti shitet ne fund me ankand dhe aspak pales se interesuar, kjo bazuar ne VKM 926 dhe si e tille, informacionet dhe komunikimet me kedo ne kete faze te procesit demtojne rende parimin e besueshmerise dhe barazise se pjesemarrjesve ne ankand e cila zhvillohet nga Drejtoria e Shitjes		

12	06.01.2026	Cilat janë veprimet e ndërmarra për operacionalizimin e integrimit të PPP-ve/koncesioneve në Listën. Unike Kombëtare të Projekteve, në vijim të ndryshimeve ligjore të VKM nr. 887, datë 27.12.2022,për "Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike";− nëse Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka hartuar apo propozuar (draft)ndryshime ligjore në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 për "Ndihmën Shtetërore" për të siguruar pavarësi në operacionale të Autoritetit përkatës dhe parashikimet buxhetore përkatëse. Nëse po, ju lutem tëpërcillni kopjet përkatëse. Nëse jo, ju lutem informoni nëse Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në cilësinë e institucionit përgjegjës për raportimin e zbatimit të kësaj mase, ka kryer apo kontribuar analizë për projektligjin e depozituar në Kuvend nga një deputet. Gjithashtu,informoni nëse Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka kryer	21.3.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj, lidhur me zbatimin e masave të Reformës së Agjendës, ju informojmë se Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) ka ndërmarrë një reformë të rëndësishme me qëllim sigurimin e pavarësisë operacionale në fushën e Ndihmës Shtetërore, përmes krijimit të Autoritetit të Ndihmës Shtetërore.Në këtë kuadër, janë hartuar ndryshime në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të cilat synojnë:• Pavarësi vendimmarrëse – krijimin e një Agjencie nën varësinë e MEI, e pajisur me autonomi operacionale për vlerësimin e çdo skeme ndihme shtetërore;• Përputhshmëri me legjislacionin e BE-së – përgatitjen e draft-paketës ligjore (ligji, VKM-të përkatëse dhe Tabela e Konformitetit) me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare të projektit SANECA, e cila është dërguar për mendim pranë Komisionit Evropian.Gjithashtu, ju informojmë se Këshilli i	Përfunduar. Kthim përgjigje pak me vonese per shkak se informacioni i kerkuar kerkonte rakordim me 2 drejtori ne MEI dhe per nje pjese te informacionit transferuar kerkesesa ne nje autoritet tjeter publik.	Nuk ka

		konsultime (ndër)institucionaleapo me grupe shoqërore mbi draftin e propozuar.− Ju lutem, përcillni kopjen e vlerësimit fillestar të kryer në qershor 2024 mbi ndryshimet ligjorepër garantimin e pavarësisë operative të Autoritetit, të cituar në faqen 21675 të AgjendësKombëtare të Reformave 2024-2027.		Ministrave ka miratuar ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 570, datë 3.10.2018, "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore", përmes Vendimit nr. 363, datë 30.6.2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 570, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave".Këto ndryshime synojnë forcimin e kuadrit të qeverisjes, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e funksionimit të këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore.Në lidhje me kërkesën për informacion, sa i takon operacionalizmit, pra vënies në zbatim të integrimit të PPP-ve/koncesioneve në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, kërkuesi duhet t'i drejtohet Ministrisë së Financës dhe/ose SASPAC pasi janë këto që kanë fushë përgjegjësie Listën Unike në fjalë dhe bëjnë përfshirjen e projekteve me miratim të Komitetit të Planifikimit Strategjik.Sa na takon ne si ministri, në		

				kuadër të grupit të punës për hartimin e ligjit te ri për koncesionet dhe PPP (nr. 88/2025), kemi siguruar që të ketë një integrim të legjislacionit për koncesionet/PPP-të me VKM 887 për procedurat e menaxhimit të investimeve publike. I lutemi kërkuesit t'i referohet pikave 4-6 të Nenit 23 të ligjit 88/2025.		

13	29.01.2026	Ne muajn Tetor 2025 kam bere nje kerkese per privatizim te nje ambienti .Dokomentacioni i dorezuar nga ana ime gjenden prane jush me NR.PROT. 438.	29.01.2026	Me anë të shkresës nr. 5000 prot., datë 08.04.2025, depozituar pranë ish-Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Fatmir Bakalli ka paraqitur kërkesë për fillimin e procesit të privatizimit për objektin “bodrum”, i ndodhur në lagjen “Kongresi i Elbasanit”, në pronësi të Bashkisë Elbasan. Për këtë kërkesë është dhënë përgjigje me shkresën nr. 5000/1 prot., datë 17.04.2025.Sqarojmë se gjatë muajit tetor nuk disponojmë asnjë kërkesë të paraqitur nga Z. Fatmir Bakalli.	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

14	29.01.2026	Ne daten 11.11.2025 kam derguar me poste dy diploma per kursanten Adela Lleshi te cilat jane leshuar nga une prane subjektit tim Jana Buli me nr Lishence NR.-0264-09-2009 nga Qendra Kombetare e Lishencimit.Kerkoj nga ana juaj njesimin e diplomave sepse vajzes i duhen per jashte shtetit,	29.01.2026	Kthyer përgjigje sipas kërkesës..	Përfunduar. Kthim përgjigje.	Nuk ka
15	27.01.2026	Aplikimin për pajisje me licencë formimi profesional, me numër aplikimi LC-6077-12-2025	0402.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me aplikimin për pajisje me licencë formimi profesional, me numër aplikimi **LC-6077-12-2025**, në emër të subjektit "Fjorabla Bajro", sqarojmë se shqyrtimi i aplikimit ka përfunduar.Vendimi përkatës ka dalë dhe është i pasqyruar në llogarinë **e-Albania** të subjektit, pasi është ngarkuar nga ana e Ministrisë përmes këtij portali.Për lehtësi referimi,	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

				përgjigjen po jua bashkëlidhim sërish edhe në këtë komunikim		

16	15.01.2026/05.02.2026	Në datën 7. 11. 2025 më është aprovuar aplikimi për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratë për Emiliana Kola me Nr. BS280320250026, jam interesuar vazhdimisht në bankë por më thonë që nuk kanë shkuar ende listat nga ana juaj. Mund të kem një ingormacion nga ana juaj ju lutem se në çfarë faze është procesi që të mund të vijoj procedurat me Bankën.	15.4.2025	Ju jeni kualifikuar si perfituese e kredise se administrates publike me interes 0% , si punonjese e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjise. Ne zbatim te vkm 468, date 26.7.2023 Enti Kombetar I Banesave ka percjell shkresen me listen e fitueseve prane Bankes Raiffaisen me date 24.12.2025.Munde te paraqiteni ne nje nga deget e Bankes Raiffaisen per te vazhduar procedurat.	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka

17	03.02.2026	Kerkese ne vijim te nje kerkese te perseritur. Dua të shtoj se kam dorëzuar foto të të gjithë banesës, e cila ka nevojë për restaurim të plotë. Kjo është pranuar edhe nga Shërbimi Social, bazuar në komunikimet që kemi pasur më parë.Dua të di pse bashkia ka në fokus vetëm këtë pjesë dhe jo pjesët e tjera kritike të banesës.	04.02.2026	Bazuar ne nenin 73 te ligjit nr. 22/2018 "Per strehimin social",i ndryshuar, njesia e veteqeverisjes vendore eshte pergjegjese per zbatimin e politikave te strehimit. Per rrjedhoje, bashkia eshte institucioni kompetent per verifikimin e kushteve te baneses dhe per percaktimin e nderhyrjeve te nevojshme, ne perputhje me fondin maksimal te akorduar.Per çdo sqarim te metejshem, ju ftojme te vijoni komunikimin me bashkine perkatese, e cila eshte pergjegjese per trajtimin e çeshtjeve te lidhura me aspektet teknike te zbatimit te programit	Përfunduar. Kthim përgjigje	Nuk ka